



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 84, datë 11.04.2018

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S, “GJENDJA E SEKTORIT TË ENERJISË DHE VEPRIMTARIA E ERE-S GJATË VITIT 2017”

Në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 21 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2018, mbasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2017”, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Konstatoi :

- ERE në zbatim të parashikimeve të nenit 25 të Ligjit nr.43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, dhe nenit 21 të ligjit nr.102/2015 “*Për Sektorin e gazit natyror*”, paraqet në Kuvend raportin vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë elektrike, gazit natyror dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin paraardhës brenda datës 31 Mars.
- ERE me shkresën nr.139/1 datë 23.03.2018, i’u drejtuar Kuvendit të Shqipërisë me kërkesën për shtyrjen e afatit të dorëzimit të Raportit vjetor, për shkak të depozitimit me vonësë të të dhënave nga operatorët e licencuar.
- Me shkresën nr 330/2 prot datë 03.04.2018 Kuvendi iShqipërisë iu përgjigj ERE-s duke u shprehur për pranimine shtyrjes së këtij afati deri në datë 15.04.2018.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2017”, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (Raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.